



REPUBLIKA E MAQEDONISË
Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi

RAPORT HULUMTUES
**DALLIMI NË PAGA NË
BAZË TË GJINISË NË
NIVEL NACIONAL**

Dhjetor 2015

Publikim: Raport hulumtues: Dallimi në paga në bazë të gjinisë në nivel nacional

Redaktore: Dr. Zhaneta Poposka

Autor: Prof. Dr. Jovan Ananiev

Universiteti “Goce Dellçev” - Shtip

Lektura: Elena Georgievska

Disenji, redaktimi dhe botimi: “Skenpoint”

Tirazhi: 150 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

331.2:305(047)

АНАНИЕВ, Јован

Истражувачки извештај : разлика во плати врз основ на пол на национално ниво / [Јован Ананиев]. - Скопје : ОБСЕ, 2015. - 57, 57 стр. : илустр. ; 30 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Raporti hulumtues : dallimi në pagë në bazëtë gjinisë në nivel nacional / Jovan Ananiev. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Предговор / Душко Миновски: стр. 4

ISBN 978-608-4788-01-0

I. Ananiev, Jovan види Ананиев, Јован

а) Плати - Родови аспекти - Извештаи

COBISS.MK-ID 100219658

Mbështetur nga:



**Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Skopje**

Përmbajtja e këtij botimi nuk i pasqyron çdoherë pikëpamjet ose qëndrimet e Misionit të OSBE në Shkup.

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Hyrje	5
KORNIZA METODOLOGJIKE E HULUMTIMIT	6
1.1 Qëllimi i hulumtimit	6
1.2. Hipotezat	6
1.3. Teknikat e hulumtimit: për grumbullimin e të dhënave	6
1.4. Përpunimi i të dhënave.....	13
2. KONSTATIMET NGA HULUMTIMI	14
2.1. Struktura dhe numri i të punësuarve.....	14
2.2. Neto paga mesatare	25
3. KONKLUSIONE	39
4. REKOMANDIME	40

PARATHËNIE

Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të vet i është përkushtuar plotësisht parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të gjinisë. Barazia gjinore në fusha të ndryshme të jetës shoqërore është vënë në pikëpyetje, ndërkaq para së gjithash, trajtimi i pabarabartë i femrave në raport me meshkujt. Pabarazi të këtilla janë evidentuar në fushën e marrëdhënieve të punës, mbrojtjes shëndetësore, veprimtarive sociale, në fushën e banimit, arsimit, politikës dhe ngjashëm. Komisioni vazhdimisht synon që hendeku i pabarazisë të zvogëlohet ndërsa qytetarët dhe kreatorët e politikave të jenë më të ndërgjegjshëm sa i përket kësaj dukurie.

Edhe nga hulumtimi paraprak, i realizuar në vitin 2013, i cili kishte të bëjë me diskriminimin në konkurset për punësim, por edhe nga ky hulumtim, mund të konkludojmë se në fushën e marrëdhënieve të punës diskriminimi i femrës është evident, ndërkaq në sektorë të caktuar është alarmant. Mundësia që femrat të fitojnë njëlloj si edhe meshkujt dhe mundësia e avancimit në karrierë është puna e parë të cilën duhet ta sigurojë çdo subjekt afarist në shtet.

Ky hulumtim ofron të dhëna të cilat do t'i ndihmojnë Komisionit që të konstatojë situata të caktuara të diskriminimit të kamufluar në bazë të gjinisë, si dhe të propozojë masa për tejkalimin e problemeve, Nga ana tjetër, rezultatet dhe rekomandimet janë të dobishme për kreatorët e politikave, sindikatat dhe dhomat ekonomike.

Dushko Minovski

Kryetar

Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi

HYRJE

Hulumtimi u realizua me ndihmën e plotësimit të pyetësorëve anketues nga ana e subjekteve afariste në shtet, të përcaktuar sipas zgjedhjes së rastësishme në bazë të respektimit të proporcionit të numrit të subjekteve afariste në sektorë të caktuar të veprimtarisë me numrin e subjekteve afariste të anketuar në modelin konkret, si dhe mbahej llogari që shpërndarja e tyre të jetë përafërsisht proporcionale, varësisht nga rajonet planor. Të dhënat janë fituar në mënyrë kumulative në nivel të subjektit afarist, ndërsa njësia e modelit është vet subjekti afarist. Me përlllogaritjen e vlerave mesatare u fituan rezultate të cilat janë indikative për objektin e hulumtimit. Të dhënat janë përpunuar në Programin SPSS, përmes shfrytëzimit të filtrave dhe fitimit të frekuencave, kryqëzimit dhe analizës X - katror. Pasqyra është statistikore dhe në vende të caktuara përshkruese me hapësirë për konkluzione të cilat mund të rezultojnë nga raporti, ndërkohë që të njëjtat nuk janë theksuar në analizë.

Rezultatet janë grupuar në dy pjesë: pasqyrë e numrit të të punësuarve dhe pasqyrë e pagave. Përmes pasqyrës dhe analizës të numrit të të punësuarve, mund të konstatohet se a ekziston devijim i konsiderueshëm midis numrit të meshkujve dhe femrave të punësuar, se a ekziston devijim i konsiderueshëm në kuadër të strukturave të caktuara etnike, në kuadër të personave me aftësi të kufizuara dhe në kuadër të rajoneve planore, por perceptuar në bazë të gjinisë. Gjithashtu, mund të konstatohen edhe fakte të cilat vënë në dukje distribuimin e vendeve të punës, midis meshkujve dhe femrave, varësisht nga madhësia e subjektit afarist.

Në pjesën e dytë, përmes pagës mesatare, në nivel të subjektit afarist dhe përmes vlerave mesatare mund të konstatohet dallimi në nivel nacional por edhe sipas sektorëve të caktuar të veprimtarive, rajoneve dhe tek personat me aftësi të kufizuara - analizuar përmes proporcionit të pagave midis meshkujve dhe femrave.

Të dhënat statistikore, të fituara nga hulumtimi, mundësojnë që të testohen edhe hipoteza shtesë. Konkluzionet dhe rekomandimet nga analiza duhet të kontribuojnë në drejtim të dëshmimit statistikor të diskriminimit të femrave, por edhe të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të kontribuojnë si argument në luftën kundër këtij fenomeni. Çdo krijim i politikës së caktuar fillon me analizë fillestare, ndërkaq kjo duhet të kontribuojë në drejtim të analizave të deritanishme, në mënyrë që të ndihmojnë në gjetjen e modeleve për tejkalimin e situatës. Veç kësaj, duhet t'u ndihmojë edhe sindikatave dhe dhomave ekonomike që të kenë një pasqyrë më reale, në mënyrë që të fillojnë të ndërmarrin masa për zvogëlimin e hendekut të pagave.

1. KORNIZA METODOLOGJIKE E HULUMTIMIT

1.1. Qëllimi i hulumtimit

- Të përcaktohet gjendja faktike aktuale sa i përket dallimit në paga midis meshkujve dhe femrave;
- Të përcaktohet dallimi në paga midis personave të cilët janë dhe nuk janë të kategorizuar si persona me aftësi të kufizuara
- Të përcaktohet dallimi në paga midis meshkujve dhe femrave të cilët janë kategorizuar si persona me aftësi të kufizuara;
- Të sigurohen informata për specifikën e dallimit në paga midis meshkujve dhe femrave në sektorë të caktuar të veprimtarive;
- Të sigurohen informata për dallimet në paga midis meshkujve dhe femrave në rajone të caktuara planore;
- Të sigurohen informata për lidhjen midis sektorit të veprimtarisë dhe pagës së personave me aftësi të kufizuara, meshkuj dhe femra;
- Të sigurohen informata për lidhjen midis sektorit të veprimtarisë dhe përkatësisë etnike, perceptuar nga aspekti i strukturës gjinore;
- Të sigurohen informata për proporcionin e strukturës udhëheqëse midis meshkujve dhe femrave dhe përfaqësimit të tyre në sektorë të caktuar.

1.2. Hipoteza

<u>Hipoteza kryesore e hulumtimit</u>	
Në nivel nacional supozohet se ka diskriminim indirekt të femrës në fushën e marrëdhënieve të punës sa i përket lartësisë së pagës midis meshkujve dhe femrave, i cili manifestohet në sektorin privat dhe është rezultat i faktorëve ekonomik, socio-kulturor dhe historik, si dhe në sektorin publik dhe privat përmes përqindjes më të ulët të përfaqësimit në pozita udhëheqëse, e që është bazë për paga më të ulëta.	
<u>Hipoteza e veçantë 1:</u>	Në nivel nacional supozohet se ka diskriminim të tërthortë në fushën e marrëdhënieve të punës, sa i përket lartësisë së pagës <i>midis meshkujve dhe femrave</i> , i cili <i>më së shumti është i shprehur në sektorët e prodhimit dhe veprimtarive shërbëse.</i>
<u>Hipoteza e veçantë 2:</u>	Në nivel nacional supozohet se ka diskriminim të tërthortë në fushën e marrëdhënieve të punës, sa i përket lartësisë së pagës <i>midis meshkujve dhe femrave</i> , i cili <i>shpeshherë është kombinuar me baza të tjera të diskriminimit.</i>

1.3. Teknika hulumtuese: për grumbullimin e të dhënave

Analiza përgatitore vuri në dukje se Enti Shtetëror i Statistikave posedon evidencë të pagave për sektorë të caktuar, të bazuara në modelin e 4000 subjekteve të zgjedhura afariste. Megjithatë, meqë të gjithë nuk e kanë plotësuar të dhënë e pagës, të bazuar mbi gjininë, të dhënat e këtyra nuk janë të kompletuara dhe prandaj Enti nuk i publikon. Ky është shkaku se pse në këtë hulumtim nuk janë shfrytëzuar treguesit nga hulumtimi i cekur dhe nuk mund të testohet një korrelacion i caktuar i rezultateve.

1.3.1. Bazat e grumbullimit të të dhënave

1.3.1.1. Sigurimi i të dhënave për subjektet afariste nga Regjistri Qendror

Kompletimi i bazës së subjekteve afariste nga Regjistri Qendror, nga Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Regjistri i Personave të tjerë Juridikë të cilët janë regjistruar në regjistrat. Kjo bazë duhet të prezantohet sipas komunave aty ku është regjistruar subjekti afarist dhe t'i përmbajë të dhënat si vijojnë:

- Emërtimin e subjektit afaristë;
- Numrin unik amë të subjektit (NUAS);
- Komuna në të cilën është regjistruar;
- Adresa;
- Sektori i veprimtarisë në të cilin funksionon (veprimtaria primare, nëse ka theksuar më shumë veprimtari);
- Madhësia e subjektit afarist sipas numrit të të punësuarve.

1.3.1.2. Përcaktimi i modelit për hulumtim dhe numri i subjekteve afariste të cilëve u janë dërguar pyetësorët

Numri i përgjithshëm i subjekteve afariste aktive në vitin 2014 ishte 70 659. Nëse e dimë se 3972 subjekte afariste nuk kanë asnjë të punësuar, ndërsa 60 215 kanë nga një deri në nëntë të punësuar (që do të thotë se kemi përqindje të madhe të atyre të cilët kanë vetëm nga një të punësuar), modeli i 500 subjekteve afariste është reprezentativ rreth 1% dhe është tërësisht i mjaftueshëm që të fitohen të dhëna relevante, si dhe gabimi statistikor të jetë në minimum. Në tabelën në vijim janë prezantuar të dhëna se nga sa subjekte afariste janë përfshirë nga veprimtari të caktuara. Është respektuar aspekti reprezentativ i modelit, por vetëm sa i përket numrit të subjekteve afariste dhe sa i përket sektorit të veprimtarisë. Madhësia e subjektit dhe rajonit në të cilin vepron është marrë parasysh gjatë seleksionimit të subjekteve afariste, por ky nuk është kriter për aspektin reprezentativ. Në Tabelën 1 është prezantuar modeli, përkatësisht në kolonën e parë theksohet sektori i veprimit, në kolonën e dytë numri i subjekteve afariste në sektorin përkatës, në kolonën e tretë përqindja, ndërsa në të katërtën numri i subjekteve afariste të cilat do të jenë njësi të analizës në këtë hulumtim. Është respektuar proporcioni tek sektorët e veprimtarive të cilat janë përfaqësuar me më shumë se 1% sipas numrit të subjekteve afariste. Sektorët e tjerë grupohen dhe tek ata do të analizohen gjithsej 10 subjekte afariste, meqë përqindja e përgjithshme e përfaqësimit të tyre është 2,2%.

Tabela 1

Bujqësi, pylltari dhe peshkim	2 842	4,0	20
Miniera dhe nxjerrja e gurit	180	0,3	
Industria e përpunimit	7 675	10,9	55
Furnizimi me energji elektrike, termike, gaz dhe klimatizim	151	0,2	
Furnizimi me ujë; shkarkimi i ujërave të zeza, menaxhimi me mbeturinat dhe veprimtari për revitalizimin e mjedisit	298	0,4	
Ndërtimtari	4 349	6,2	30
Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	24 674	34,9	170
Transporti dhe magazinimi	5 919	8,4	40
Objekte për magazinim dhe veprimtari shërbyese me ushqim	4 493	6,4	30
Informata dhe komunikime	1 475	2,1	10
Veprimtari financiare dhe veprimtaritë e sigurimeve	400	0,6	
Veprimtari në lidhje me pronën e paluajtshme	507	0,7	
Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	6 095	8,6	40
Veprimtari administrative dhe veprimtari ndihmëse shërbyese	1 554	2,2	10
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social	264	0,4	
Arsimi	1 064	1,5	10
Veprimtaritë e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale	3 322	4,7	25
Art, argëtim dhe rekreacion	1 185	1,7	20
Veprimtari të tjera shërbyese	4 212	6,0	30
Veprimtari të ekonomive familjare si punëdhënës; veprimtari të ekonomive familjare të cilat prodhojnë produkte të ndryshme dhe kryejnë shërbime të ndryshme për nevojat e tyre	-	-	-
Veprimtaritë e organizatave dhe organeve eks-territoriale	-	-	-

1.3.1.3. Dërgimi i pyetësorëve deri te subjektet afariste

Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi me shkresë zyrtare deri te subjekti afarist i zgjedhur rastësisht, në bazë të kriterëve të përshkruara më lartë, ia dërgoi pyetësorin i cili është prezantuar në vijim. Së këtejmi, u theksua se të dhënat që do t'i ofrojnë subjektet afariste janë ekskluzivisht për nevojat e këtij hulumtimi dhe nuk do të shfrytëzohen për qëllime të tjera, ndërsa garantohet diskrecioni i të dhënave për çdo subjekt afarist.

P Y E T Ë S O R

Për strukturën e të punësuarve dhe për neto pagën e tyre

1. Sektori i veprimtarisë së subjektit afarist *(e rrethon vetëm atë veprimtari e cila është primare)

1. Bujqësi, pylltari dhe peshkim
2. Miniera dhe nxjerrja e gurit
3. Industria e përpunimit
4. Furnizimi me energji elektrike, termike, gaz dhe klimatizim
5. Furnizimi me ujë; shkarkimi i ujërave të zeza, menaxhimi me mbeturinat dhe veprimtari për revitalizimin e mjedisit
6. Ndërtimtari
7. Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave
8. Transporti dhe magazinimi
9. Objekte për magazinim dhe veprimtari shërbyese me ushqim
10. Informata dhe komunikime
11. Veprimtari financiare dhe veprimtaritë e sigurimeve
12. Veprimtari në lidhje me pronën e paluajtshme
13. Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike
14. Veprimtari administrative dhe veprimtari ndihmëse shërbyese
15. Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social
16. Arsimi Veprimtari të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale
17. Art, argëtim dhe rekreacion
18. Veprimtari të tjera shërbyese
19. Veprimtari të ekonomive familjare si punëdhënës; veprimtari të ekonomive familjare të cilat prodhojnë produkte të ndryshme dhe kryejnë shërbime të ndryshme për nevojat e tyre
20. Veprimtari të organizatave dhe organeve eks-territoriale

2. Komuna në të cilën është regjistruar subjekti afarist -----
3. Numri i përgjithshëm i të punësuarve: -----
4. Neto paga mesatare e paguar për muajin maj të vitit 2015

	Mesh- kuj	Shifra (plotësohet nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi)	Femra	Shifra (plotësohet nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi)
5. Numri i të punësuarve në bazë të gjinisë				
6. Përkatësia etnike				
1. Maqedonas		1		2
2. Shqiptarë		3		4
3. Turq		5		6
4. Romë		7		8
5. Serbë		9		10
6. Vlleh		11		12
7. Boshnjakë		13		14
7. Shtetësia				
1. Maqedonase		1		2
2. I huaj		3		4
8. Arsimi				
1. I lartë		1		2
2. I mesëm		3		4
3. Fillor		5		6
9. Numri i personave të cilët janë kategorizuar si persona me invaliditet		1		2
10. Neto paga mesatare e paguar për muajin maj të vitit 2015		1		2
11. Neto paga mesatare e paguar për muajin maj të vitit 2015 për persona me invaliditet		1		2
12. Persona të cilët kanë pozitë udhëheqëse				

13. Sa është neto paga mesatare e të punësuarve me arsim të lartë e paguar për muajin maj të vitit 2015 ----- denarë
14. Sa është neto paga mesatare e të punësuarve me arsim të mesëm e paguar për muajin maj të vitit 2015 ----- denarë
15. Sa është neto paga mesatare e të punësuarve me arsim fillor e paguar për muajin maj të vitit 2015 ----- denarë

1.3.2. Pyetësorë të pranuar


Në këtë pjesë duhet të theksohet se nga 500 pyetësorët e dërguar, Komisioni, përmes postës ose në mënyrë elektronike pranoi 173 pyetësorë të përgjigjur. Procesi i dërgimit të pyetësorëve u prolongua, ndërsa subjektet afariste, të cilët nuk i kishin dërguar pyetësorët i përkujtuam që një gjë të këtillë ta bëjnë në afatin e prolonguar. U konstatua se më shumë se gjysma e subjekteve afariste nuk i kanë dërguar pyetësorët e plotësuar, me ç'rast në një shkallë të caktuar e ngushton modelin dhe e redukton aspektin reprezentativ sipas sektorit të veprimtarisë së subjektit afarist, i cili ishte kriteri kryesor për disenjimin e modelit. Në Tabelën 2 dhe Grafikun 1 është prezantuar modeli hulumtues në bazë të pyetësorëve të pranuar.

Tabela 2

Sektori i veprimtarisë së subjektit afarist

	Frekuenca	Përqinja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
nuk ka të dhëna	7	4,0	4,0	4,0
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	9	5,2	5,2	9,2
Miniera dhe nxjerrja e gurit	9	5,2	5,2	14,5
Industria e përpunimit	5	2,9	2,9	17,3
Furnizimi me energji elektrike, termike, gaz dhe klimatizim	4	2,3	2,3	19,7
Furnizimi me ujë; shkarkimi i ujërave të zeza, menaxhimi me mbeturinat dhe veprimtari për revitalizimin e mjedisit	1	,6	,6	20,2
Ndërtimtari	12	6,9	6,9	27,2
Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	53	30,6	30,6	57,8
Transporti dhe magazinimi	8	4,6	4,6	62,4
Objekte për magazinim dhe veprimtari shërbyese me ushqim	9	5,2	5,2	67,6
Informata dhe komunikime	3	1,7	1,7	69,4
Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	4	2,3	2,3	71,7
Veprimtari administrative dhe veprimtari ndihmëse shërbyese	2	1,2	1,2	72,8
Arsimi	5	2,9	2,9	75,7
Veprimtari të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale	7	4,0	4,0	79,8
Veprimtari të tjera shërbyese	30	17,3	17,3	97,1
Veprimtari të ekonomive familjare si punëdhënës;	2	1,2	1,2	98,3
Veprimtari të organizatave dhe organeve eks-territoriale	3	1,7	1,7	100,0
Gjithsej	173	100,0	100,0	

Grafiku 1
Sektori i veprimtarisë së subjektit afarist?




Në Tabelën 3 dhe Grafikon 2 është prezantuar modeli i njëjtë sipas rajonit planor nga i cili vijnë subjektet e analizuara afariste.

Tabela 3

Rajoni në të cilin është regjistruar subjekti afarist

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
Lindor	10	5,8	5,8	5,8
Juglindor	14	8,1	8,1	13,9
I Vardarit	25	14,5	14,5	28,3
I Pellagonisë	12	6,9	6,9	35,3
Jugperëndimor	12	6,9	6,9	42,2
I Pollogut	17	9,8	9,8	52,0
I Shkupit	59	34,1	34,1	86,1
Verilindor	14	8,1	8,1	94,2
nuk ka të dhëna	10	5,8	5,8	100,0
Gjithsej	173	100,0	100,0	

Grafiku 2
Rajoni në të cilin është regjistruar subjekti afarist?




Në Tabelën 4 dhe Grafikon 3 është prezantuar modeli i njëjtë sipas numrit të përgjithshëm të të punësuarve në subjektet e analizuara afariste.

Tabela 4

Numri i përgjithshëm i të punësuarve

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
Nuk ka të punësuar	1	,6	,6	,6
1 i punësuar	2	1,2	1,2	1,7
prej 2 deri 10 të punësuar	11	6,4	6,4	8,1
prej 11 deri 20 të punësuar	47	27,2	27,2	35,3
prej 21 deri 30 të punësuar	33	19,1	19,1	54,3
prej 31 deri 40 të punësuar	15	8,7	8,7	63,0
prej 41 deri 50 të punësuar	13	7,5	7,5	70,5
prej 51 deri 60 të punësuar	10	5,8	5,8	76,3
prej 61 deri 70 të punësuar	6	3,5	3,5	79,8
prej 71 deri 80 të punësuar	5	2,9	2,9	82,7
prej 81 deri 90 të punësuar	3	1,7	1,7	84,4
prej 91 deri 100 të punësuar	2	1,2	1,2	85,5
mbi 100 të punësuar	21	12,1	12,1	97,7
nuk ka të dhëna	4	2,3	2,3	100,0
Gjithsej	173	100,0	100,0	

Grafiku 3
Numri i përgjithshëm i të punësuarve



1.4. Përpunimi i të dhënave

Pyetësorët e dërguar nga subjektet afariste deri te Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, fillimisht u kontrolluan në mënyrë që të evitohen gabimet e caktuara logjike në të dhënat dhe pastaj iu qas së ashtuquajturës mbyllje të çështjeve të hapura përmes përcaktimit të kodeve për të dhënat e grupuara (për shembull, nëse paga mesatare në nivel të subjektit afarist është 23 000 denarë, kjo e dhënë do të përfshihet në modalitetin prej 21 000 deri 30 000 denarë të cilit i përcaktohet një kod i caktuar). Pastaj, iu qasëm përcaktimit të variablave (ndryshoreve) në softuerin për përpunim statistikor në shkencat shoqërore SPSS dhe përcaktimit të vlerave, përkatësisht modaliteteve. Në bazë të protokollit për kodim, çdo përgjigje ose grup i përgjigjeve të pyetësorit e fitoi kodin e vet dhe iu qasëm futjes së të dhënave nga çdo pyetësor, për shkak të kontrollit të efikasitetit dhe saktësisë së futjes së të dhënave, çdo pyetësori iu përcaktua shifër e cila njëkohësisht është edhe numri i rendit të qelive në të cilat futet pyetësori, përkatësisht çdo rend e përfaqëson pyetësorin.

Përpunimi filloi me procesin e filtrimit, përkatësisht me shmangien e atyre kodeve që nënkuptojnë “nuk ka të dhëna” ose “nuk ka përgjigje” ose përcaktojnë “të dhëna zero” në mënyrë që të fitohet model sa i përket çdo variable sensitive prej 100%. Pastaj, iu qasëm fitimit elementar të frekuencave për variablat e varura, kryqëzimin e variablës së pavarur me të varur, kryqëzimin e variablës së pavarur me dy variabla të varura, përcaktimin e mesatareve, progresioneve lineare dhe testimin e hipotezave.

Vërejtjet paraprake gjatë interpretimit të të dhënave

Ky hulumtim është realizuar në bazë të pyetësorëve të dërguar deri te subjektet afariste. Njësi e modelit janë subjektet afariste, ndërsa nuk janë të punësuarit dhe prandaj rezultatet kanë të bëjnë me të njëjtit. Të dhënat që fitohen për personat e punësuar, siç u tha paraprakisht, grupohen dhe së këtëjmi bëhet fjalë për interpretimin e të dhënave të grupuara. Kur bëhet fjalë për krahasimin e pagave, meqë janë variabla të varura nuk kërkohet korrelacioni midis tyre, por bëhet vetëm krahasimi, ndërsa pasqyrimi i tyre nuk bëhet përmes ndërvlerësive por përmes krahasimit të vlerave mesatare.

2. KONSTATIMET NGA HULUMTIMI

2.1. Struktura dhe numri i të punësuarve

Gjinia


Nga rezultatet e hulumtimit është evidente se dominojnë subjektet afariste në të cilat **numri i të punësuarve** është prej 11 deri 20, pastaj me një dallim të vogël në përqindje pasojnë ato subjekte afariste me 21 deri 30 të punësuar. Në 58 subjekte afariste numri i meshkujve është prej 11 deri 20 ndërsa në 41 subjekte afariste, numri i meshkujve të punësuar është prej 2 deri 10. Në 73 subjekte afariste numri i femrave është prej 2 deri 10, ndërsa në 41 subjekte afariste numri i femrave të punësuar është prej 11 deri 20 të punësuar. Në Tabelën 5 dhe Tabelën 6 dhe në mënyrë përkatëse në Grafikun 4 dhe Grafikun 5 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar në bazë të gjinisë në subjektet e analizuara afariste.

Tabela 5

Numri i të punësuarve në bazë të gjinisë (meshkuj)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 i punësuar	4	2,3	2,5	2,5
prej 2 deri 10 të punësuar	41	23,7	25,3	27,8
prej 11 deri 20 të punësuar	58	33,5	35,8	63,6
prej 21 deri 30 të punësuar	20	11,6	12,3	75,9
prej 31 deri 40 të punësuar	14	8,1	8,6	84,6
prej 41 deri 50 të punësuar	5	2,9	3,1	87,7
prej 51 deri 60 të punësuar	2	1,2	1,2	88,9
prej 61 deri 70 të punësuar	2	1,2	1,2	90,1
prej 71 deri 80 të punësuar	4	2,3	2,5	92,6
prej 81 deri 90 të punësuar	2	1,2	1,2	93,8
mbi 100 të punësuar	10	5,8	6,2	100,0
Gjithsej	162	93,6	100,0	
nuk ka të punësuar	6	3,5		
nuk ka të dhëna	5	2,9		
Gjithsej	11	6,4		
Total	173	100,0		

Grafiku 4




Numri i të punësuarve në bazë të gjinisë (meshkuj)

Tabela 6

Numri i të punësuarve në bazë të gjinisë (femra)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 e punësuar	8	4,6	4,9	4,9
prej 2 deri 10 të punësuar	73	42,2	45,1	50,0
prej 11 deri 20 të punësuar	28	16,2	17,3	67,3
prej 21 deri 30 të punësuar	15	8,7	9,3	76,5
prej 31 deri 40 të punësuar	12	6,9	7,4	84,0
prej 41 deri 50 të punësuar	6	3,5	3,7	87,7
prej 51 deri 60 të punësuar	3	1,7	1,9	89,5
prej 61 deri 70 të punësuar	4	2,3	2,5	92,0
prej 71 deri 80 të punësuar	1	,6	,6	92,6
prej 81 deri 90 të punësuar	1	,6	,6	93,2
mbi 100 të punësuar	11	6,4	6,8	100,0
Gjithsej	162	93,6	100,0	
nuk ka të punësuar	6	3,5		
nuk ka të dhëna	5	2,9		
Gjithsej	11	6,4		
Gjithsej	173	100,0		

Grafiku 5



Numri i të punësuarve në bazë të gjinisë (femra)

Përkatësia etnike

Maqedonaset janë të përfaqësuara në 86% të subjekteve afariste dhe kryesisht në subjektet afariste në të cilat numri i maqedonaseve është prej 2 deri në 10. **Maqedonasit** janë të përfaqësuar në 92% të subjekteve afariste prej të cilëve më shumë se gjysma janë të punësuar në subjekte afariste me 2 deri 10 të punësuar dhe prej 11 deri 20 maqedonas të punësuar, në Tabelën 7 dhe Tabelën 8 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar nga bashkësia etnike maqedonase, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 7

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike - maqedonase

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
I saktë	1 e punësuar	9	5,2	6,0	6,0
	prej 2 deri 10 të punësuar	68	39,3	45,6	51,7
	prej 11 deri 20 të punësuar	29	16,8	19,5	71,1
	prej 21 deri 30 të punësuar	13	7,5	8,7	79,9
	prej 31 deri 40 të punësuar	11	6,4	7,4	87,2
	prej 41 deri 50 të punësuar	2	1,2	1,3	88,6
	prej 51 deri 60 të punësuar	2	1,2	1,3	89,9
	prej 61 deri 70 të punësuar	4	2,3	2,7	92,6
	prej 81 deri 90 të punësuar	1	,6	,7	93,3
	mbi 100 të punësuar	10	5,8	6,7	100,0
	Gjithsej	149	86,1	100,0	
	Nuk ka të punësuar	19	11,0		
	nuk ka të dhëna	5	2,9		
	Gjithsej	24	13,9		
	Gjithsej	173	100,0		

Tabela 8

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike - maqedonas (meshkuj)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 i punësuar	5	2,9	3,1	3,1
prej 2 deri 10 të punësuar	57	32,9	35,8	39,0
prej 11 deri 20 të punësuar	47	27,2	29,6	68,6
prej 21 deri 30 të punësuar	14	8,1	8,8	77,4
prej 31 deri 40 të punësuar	13	7,5	8,2	85,5
prej 41 deri 50 të punësuar	4	2,3	2,5	88,1
prej 51 deri 60 të punësuar	3	1,7	1,9	89,9
prej 61 deri 70 të punësuar	3	1,7	1,9	91,8
prej 71 deri 80 të punësuar	4	2,3	2,5	94,3
mbi 100 të punësuar	9	5,2	5,7	100,0
Gjithsej	159	91,9	100,0	
nuk ka të punësuar	9	5,2		
nuk ka të dhëna	5	2,9		
Gjithsej	14	8,1		
Gjithsej	173	100,0		

Shqiptaret janë të përfaqësuar në përafërsisht 17% nga numri i përgjithshëm i subjekteve të anketuara afariste, ndërkaq në numër konsiderueshëm dominant janë të punësuar në subjektet afariste në të cilat janë të punësuar prej 2 deri në 10 shqiptare. **Meshkujt e bashkësisë etnike shqiptare** janë të përfaqësuar në 32% nga numri i përgjithshëm i subjekteve afariste, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar në subjektet afariste të cilat kanë prej 2 deri 10 shqiptarë të punësuar.

Në të dyja rastet, edhe sa u përket shqiptareve por edhe shqiptarëve, nëse bëjmë një krahasim me grupet e tjera etnike, mund të konkludojmë se nuk janë të përfaqësuar në numër adekuat tek subjektet afariste. Supozohet se kjo situatë ka të bëjë me faktin se ato janë të koncentruar në disa rajone planore dhe për këtë shkak në subjektet afariste të cilat veprojnë në rajonet e tjera planore ato nuk janë të pranishëm. Në Tabelën 9 dhe Tabelën 10 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar të bashkësisë etnike shqiptare, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 9

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike - shqiptare

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
një e punësuar	8	4,6	27,6	27,6
prej 2 deri 10 të punësuar	19	11,0	65,5	93,1
prej 21 deri 30 të punësuar	1	,6	3,4	96,6
prej 31 deri 40 të punësuar	1	,6	3,4	100,0
Gjithsej	29	16,8	100,0	
nuk ka të punësuar	140	80,9		
nuk ka të dhëna	4	2,3		
Gjithsej	144	83,2		
Gjithsej	173	100,0		

Tabela 10

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – shqiptarë (meshkuj)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
I saktë	një i punësuar	18	10,4	32,7
	prej 2 deri 10 të punësuar	27	15,6	49,1
	prej 11 deri 20 të punësuar	4	2,3	7,3
	prej 21 deri 30 të punësuar	4	2,3	7,3
	prej 41 deri 50 të punësuar	1	0,6	1,8
	prej 71 deri 80 të punësuar	1	0,6	1,8
	Gjithsej	55	31,8	100,0
	nuk ka të punësuar	114	65,9	
	nuk ka të dhëna	4	2,3	
	Gjithsej	118	68,2	
	Gjithsej	173	100,0	

Femrat e bashkësisë etnike turke janë të përfaqësuar në 5% të subjekteve afariste, përkatësisht në 9 subjekte afariste, prej të cilëve në 55% ka vetëm nga një turke të punësuar. **Meshkujt, pjesëtarë të bashkësisë etnike turke** janë të përfaqësuar në 10% të subjekteve afariste, prej të cilave në më shumë se gjysmën janë të përfaqësuar prej 2 deri 10 turq. Në Tabelën 11 dhe Tabelën 12 në mënyrë të detajuar është pasqyruar numri i të punësuarve nga bashkësia etnike turke, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 11

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike - turke

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 e punësuar	5	2,9	55,6	55,6
prej 2 deri 10 të punësuar	3	1,7	33,3	88,9
prej 11 deri 20 të punësuar	1	,6	11,1	100,0
Gjithsej	9	5,2	100,0	
nuk ka të punësuar	160	92,5		
nuk ka të dhëna	4	2,3		
Gjithsej	164	94,8		
Gjithsej	173	100,0		

Tabela 12

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – turq (meshkuj)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
një i punësuar	8	4,6	47,1	47,1
prej 2 deri 10 të punësuar	9	5,2	52,9	100,0
Gjithsej	17	9,8	100,0	
nuk ka të punësuar	152	87,9		
nuk ka të dhëna	4	2,3		
Gjithsej	156	90,2		
Gjithsej	173	100,0		

Femrat që i përkasin bashkësisë etnike serbe janë të përfaqësuar në 7% të subjekteve afariste, me ç'rast gjysma e tyre janë të përfaqësuar në subjektet afariste me një të punësuar, ndërsa gjysma tjetër në subjektet afariste me 2 deri 10 serbe të punësuar. **Meshkujt që i përkasin bashkësisë etnike serbe** janë të përfaqësuar në 9% të subjekteve afariste, prej të cilëve një numër i madh dominant janë të përfaqësuar në ato subjekte afariste të cilët kanë një serb të punësuar. Në Tabelën 13 dhe Tabelën 14 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar nga bashkësia etnike serbe, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 13

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike - serbe

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 e punësuar	6	3,5	50,0	50,0
prej 2 deri 10 të punësuar	6	3,5	50,0	100,0
Gjithsej	12	6,9	100,0	
nuk ka të punësuar	158	91,3		
nuk ka të dhëna	3	1,7		
Gjithsej	161	93,1		
Gjithsej	173	100,0		

Tabela 14

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – serbë (meshkuj)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
një i punësuar	10	5,8	62,5	62,5
prej 2 deri 10 të punësuar	4	2,3	25,0	87,5
prej 11 deri 20 të punësuar	1	,6	6,3	93,8
prej 21 deri 30 të punësuar	1	,6	6,3	100,0
Gjithsej	16	9,2	100,0	
nuk ka të punësuar	154	89,0		
nuk ka të dhëna	3	1,7		
Gjithsej	157	90,8		
Gjithsej	173	100,0		

Femrat që i përkasin bashkësisë etnike rome janë të përfaqësuar në 8% të subjekteve afariste, e që janë të pranishme në masë dominante në subjektet afariste në të cilat ka deri në një rome të punësuar. **Meshkujt romë** janë të përfaqësuar në 12% të subjekteve afariste edhe atë thuaja se njëlloj në ato në të cilat ka një rom të punësuar ose në ato në të cilat numri i romëve të punësuar është prej 2 deri në 10. Në Tabelën 15 dhe Tabelën 16 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar të bashkësisë etnike rome, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 15

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – rome

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 e punësuar	11	6,4	78,6	78,6
prej 2 deri 10 të punësuar	3	1,7	21,4	100,0
Gjithsej	14	8,1	100,0	
nuk ka të punësuar	156	90,2		
nuk ka të dhëna	3	1,7		
Gjithsej	159	91,9		
Gjithsej	173	100,0		

Tabela 16

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – romë (meshkuj)

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
Gjithsej	1 i punësuar	10	5,8	47,6	47,6
	prej 2 deri 10 të punësuar	11	6,4	52,4	100,0
	Gjithsej	21	12,1	100,0	
	nuk ka të punësuar	149	86,1		
	nuk ka të dhëna	3	1,7		
	Gjithsej	152	87,9		
	Gjithsej	173	100,0		

Vllehet janë të përfaqësuar në 7,5% të subjektet afariste, ndërkaq në masë të konsiderueshme dominante janë të përfaqësuar në ato subjekte afariste në të cilat është e punësuar vetëm një vllehe. Meshkujt të cilët i përkasin bashkësisë etnike vllehe janë të përfaqësuar në 4,6% të subjekteve afariste me një përfaqësim të konsiderueshëm dominant në subjektet afariste, në të cilat numri i tyre është prej 2 deri 10 të punësuar. Në Tabelën 17 dhe Tabelën 18 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar nga bashkësia etnike vllehe, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 17

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – vllehe

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 e punësuar	10	5,8	76,9	76,9
prej 2 deri 10 të punësuar	3	1,7	23,1	100,0
Gjithsej	13	7,5	100,0	
nuk ka të punësuar	157	90,8		
nuk ka të dhëna	3	1,7		
Gjithsej	160	92,5		
Gjithsej	173	100,0		

Tabela 18

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – vllëh (meshkuj)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
1 i punësuar	2	1,2	25,0	25,0
prej 2 deri 10 të punësuar	6	3,5	75,0	100,0
Gjithsej	8	4,6	100,0	
nuk ka të punësuar	162	93,6		
nuk ka të dhëna	3	1,7		
Gjithsej	165	95,4		
Gjithsej	173	100,0		

Boshnjaket janë të përfaqësuar në 5% të subjekteve afariste edhe atë në numër më të madh atje ku ka prej 2 deri 10 të punësuar. **Meshkujt që i përkasin bashkësisë etnike boshnjake** janë të përfaqësuar në 4% të subjekteve afariste, në numër më të madh aty ku ka prej 2 deri 10 të punësuar. Në Tabelën 19 në mënyrë të detajuar është prezantuar numri i personave të punësuar të bashkësisë etnike boshnjake, i ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 19

Numri i të punësuarve në bazë të përkatësisë etnike – boshnjake

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e saktë	Përqindja kumulative
I saktë	1 e punësuar	3	1,7	33,3	33,3
	prej 2 deri 10 të punësuar	4	2,3	44,4	77,8
	prej 31 deri 40 të punësuar	1	,6	11,1	88,9
	prej 71 deri 80 të punësuar	1	,6	11,1	100,0
	Gjithsej	9	5,2	100,0	
	nuk ka të punësuar	161	93,1		
	nuk ka të dhëna	3	1,7		
	Gjithsej	164	94,8		
	Gjithsej	173	100,0		

Punësimi i të huajve

Meshkujt e huaj janë të punësuar në 5% të numrit të përgjithshëm të subjekteve të përfshira afariste edhe atë në numër më të madh në ato subjekte në të cilat është punësuar vetëm një i huaj. **Femrat me shtetësi të huaj** janë të punësuar në përafërsisht 4% të subjekteve afariste, edhe atë thuaja se përafërsisht në ato subjekte në të cilat ka të punësuar vetëm një femër të huaj dhe në ato të cilat kanë punësuar prej 2 deri 10 femra me shtetësi të huaj. Në Tabelën 20 dhe Tabelën 21 në mënyrë të detajuar është pasqyruar numri i të huajve të punësuar, të ndarë sipas gjinisë dhe shtetësisë së huaj.

Tabela 20

